

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të  
Brendshëm  
Internal Audit Basics**

**B2**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 17/07/2021

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

1. Auditimi i brendshëm është përgjegjës për të ndihmuar në parandalimin e mashtrimit duke:
  - A. Informuar autoritetet përkatëse brenda organizatës dhe duke rekomanduar çfarëdo hetimi që konsiderohet i nevojshëm në rrethanat kur dyshohet për mashtrim.
  - B. Krijuar sistemeve të dizajnuara për të siguruar përpunjen me politikat, planet dhe procedurat e organizatës, si dhe ligjet dhe rregulloret në fuqi.
  - C. Ekzaminuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit, në përpjesëtim me shkallën e ekspozimit/ rrezikut të mundshëm në segmente të ndryshme të operacioneve të organizatës.**
  - D. Përcaktuar nëse standardet e funksionimit janë vendosur për të matur ekonominë dhe eficientë, dhe nëse këto standarde janë kuptuar dhe po plotësohen.
  
2. Cila nga kombinimet e mëposhtme të pjesëmarrësve do të ishte më i përshtatshmi për të marrë pjesë në një takim përmblyës?
  - A. Auditori i brendshëm përgjegjës dhe përfaqësuesit nga menaxhmenti, të cilët kanë njohuri për të hollësishme për operacionet dhe ata që mund të autorizojnë zbatimin e veprimeve korrigjuese.**
  - B. Shefi ekzekutiv i auditimit dhe ekzekutivi përgjegjës për aktivitetin ose funksionin e audituar.
  - C. Stafi i auditimit që kryen punën në terren dhe personeli operativ i ngarkuar me performancën ditore të veprimtarisë ose funksionit të audituar.
  - D. Stafi i auditimit që kryen punën në terren dhe ekzekutivi i ngarkuar me aktivitetin ose funksionin e audituar.
  
3. Nga auditim i brendshëm i kontratave të shitjes të një kompanie u zbulua se ishte paguar një mitë/ryshfet për të siguruar një kontratë të madhe. Është konsideruar mjaft e mundshme që një ekzekutiv i lartë të ketë autorizuar ryshfetin. Cila nga opsionet e mëposhtme përshkruan më mirë shpërndarjen e duhur të raportit të përfunduar të auditimit?
  - A. Raporti duhet t'i shpërndahet shefit ekzekutiv dhe agjencisë përkatëse rregullatore.
  - B. Raporti duhet t'i shpërndahet bordit të drejtorëve, kryeshefit ekzekutiv dhe auditorit të pavarur.
  - C. Shefi ekzekutiv i auditimit duhet t'i sigurojë bordit të drejtorëve një kopje të raportit dhe të vendosë nëse shpërndarja e mëtejshme është e përshtatshme.**
  - D. Raporti duhet t'i shpërndahet bordit të drejtorëve, agjencisë përkatëse të zbatimit të ligjit dhe agjencisë së duhur rregullatore.
  
4. Standardet e IIA përshkruajnë provat/evidencat përkatëse si:
  - A. Fakte, adekuate dhe bindëse.
  - B. Të besueshme dhe më së miri të arritshme përmes përdorimit të teknikave të përshtatshme të auditimit.
  - C. Në përputhje me objektivat e auditimit dhe mbështesin vëzhgimet dhe rekomandimet e auditimit.**
  - D. Informacioni që ndihmon organizatën të përmbushë qëllimet e saj.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

5. Sipas standardeve të IIA, një auditor i brendshëm duhet të ketë aftësi në:
  - A. Parimet e menaxhimit.
  - B. Lëndë të tilla si kontabiliteti, ekonomi dhe financa.
  - C. Sisteme informatike të kompjuterizuara.
  - D. Zbatimin e standardeve, procedurave dhe teknikave të auditimit të brendshëm.**
  
6. Standardet e IIA kërkojnë që një auditor i brendshëm të ushtrojë kujdesin e duhur profesional në kryerjen e auditimeve të brendshme. Kjo përfshin:
  - A. Vendosja e komunikimit të drejtpërdrejtë midis drejtorit të auditimit të brendshëm dhe bordit të drejtorëve.
  - B. Vlerësimin e standardeve të vendosura të operimit dhe përcaktimi nëse ato standarde janë të pranueshme dhe janë duke u përmbushur.**
  - C. Grumbullimi i provave të mjaftueshme në mënyrë që auditori të japë siguri absolute se parregullsitë nuk ekzistojnë.
  - D. Vendosja e kriterëve të përshtatshme të arsimit dhe përvojës për plotësimin e pozicioneve të auditimit të brendshëm.
  
7. Shefi ekzekutiv i auditimit të një ndërmarrje të madhe të shitjeve me pakicë raporton tek kontrolluesi dhe është përgjegjës për hartimin dhe instalimin e aplikacioneve kompjuterike në lidhje me kontrollin e inventarit. Cila nga opsionet e mëposhtme është kufizimi kryesor i kësaj marrëveshje?
  - A. Parandalon auditorët që t'i kushtohen auditimit me kohë të plotë.
  - B. Auditorët zakonisht nuk kanë ekspertizën e kërkuar për të hartuar dhe zbatuar sisteme të tilla.
  - C. Potencialisht ndikon në pavarësinë e shefit ekzekutiv të auditimit dhe në këtë mënyrë zvogëlon vlerën e shërbimeve të auditimit.**
  - D. Marrëveshje të tilla janë të paligjshme sepse drejtori merr pjesë në funksione të papajtueshme.
  
8. Një menaxher auditimi përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rishikimin e auditorëve të tjerë ka nevojë për aftësi dhe njohuri të nevojshme. Cili nga opsionet e mëposhtme NUK përshkruan një aftësi ose njohuri të nevojshme për të mbikëqyrur një detyrë të veçantë të auditimit?
  - A. Aftësia për të rishikuar dhe analizuar një program të auditimit për të përcaktuar nëse procedurat e propozuara të auditimit do të rezultojnë në prova të rëndësishme për objektivat e auditimit.
  - B. Sigurimi që një raport i auditimit është i mbështetur dhe i saktë në lidhje me provat e dokumentuara në dokumentet e punës së auditimit.
  - C. Përdorimi i vlerësimit të rrezikut dhe proceseve të tjera gjyquese për të zhvilluar një plan dhe orar të auditimit për departamentin dhe paraqitjen e planit para komitetit të auditimit.**
  - D. Përcaktimi që stafi i auditimit kanë përfunduar procedurat e auditimit dhe se objektivat e auditimit janë përmbushur.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

9. Një statut i shkruar i miratuar nga bordi i drejtorëve, që përshkruan qëllimin, autoritetin dhe përgjegjësinë e departamentit të auditimit të brendshëm ka për qëllim kryesisht të përmirësojë:
- A. Kujdesin e duhur profesional të departamentit.
  - B. Autoritetin e departamentit brenda organizatës.
  - C. Marrëdhënien e departamentit me menaxhmentin.
  - D. Pavarësinë e departamentit.**
10. Informacioni i detajuar i biletave të linjave ajrore, duke përfshirë klasën e tarifës, datën e blerjes dhe opsionet më të ulëta të mundshme të tarifave, siç përshkruhet në politikën e udhëtimit të kompanisë, merret dhe raportohet tek menaxhmenti i departamentit kur punonjësit blejnë bileta ajrore nga agjensionet e autorizuar të udhëtimit nga kompania. Një raport i tillë ofron informacion për:
- A. Cilësinë e performancës në lidhje me politikën e udhëtimit të kompanisë.**
  - B. Identifikimin e kostove të nevojshme për të përpunuar të dhënat e raportit të shpenzimeve të punonjësve.
  - C. Krahasimin e buxhetit aktual me buxhetin e parashikuar të departamentit.
  - D. Të mbështetur zbritjet e shpenzimeve të biznesit të punëdhënësit.
11. Menaxhmenti pohoi se standardet e performancës që auditorët përdorën për të vlerësuar performancën e operimit ishin të papërshtatshme. Standardet e shkruara të performancës që ishin vendosur nga menaxhmenti ishin të paqarta dhe duhej të interpretoheshin nga auditori. Në raste të tilla, auditorët mund të përmbushin përgjegjësinë e tyre të kujdesit të duhur profesional duke:
- A. Siguruar veten se interpretimet e tyre janë të arsyeshme.
  - B. Siguruar veten se interpretimet e tyre janë në përputhje me praktikat e industrisë.
  - C. Rënë dakord me të audituarit për standardet e nevojshme për të matur performancën.**
  - D. Përfshirë kundërshtimet e menaxhmentit në raportin e auditimit.
12. Një mbikëqyrës i auditimit do të sigurohet se provat e auditimit janë të mjaftueshme për të mbështetur përfundimin se *'regjistrimet në ditar janë përgatitur dhe aprovuar siç duhet'* nëse dokumentet e punës përfshijnë:
- A. Një shënim që tregon sigurinë e kontrolluesit që regjistrimet në ditar shikohen gjithmonë nga mbikëqyrësi i kontabilitetit përpara hyrjes në sistemin kompjuterik.**
  - B. Një kopje e shkruar me dorë e një orari të regjistrimeve standarde dhe regjistrimeve të bashkangjitura jo standarde në ditar për muajin më të fundit që tregon inicialet e përgatitësit për secilin regjistrim dhe miratimin e kontrolluesit.
  - C. Një kopje e një liste të gjeneruar nga kompjuteri e regjistrimeve të automatizuara dhe regjistrimeve jostandarde të iniciuar nga kontrolluesi që tregon referencat e auditorit ndaj raporteve të sistemit dhe barazimeve mujore.
  - D. Një referim i tërthortë në një seksion tjetër të dokumenteve të punës që përmban prova të mjaftueshme për këtë përfundim.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

13. Një auditor i brendshëm gjatë auditimit ka zbuluar veprime të paligjshme të kryera nga një anëtar i menaxhmentit të lartë. Sipas standardeve të IIA, informacioni i tillë:
- A. Duhet të përjashtohet nga raporti i auditorit të brendshëm dhe të diskutohet gojarisht me menaxherin e lartë.
  - B. Duhet të raportohet menjëherë tek autoritetet përkatëse qeveritare.
  - C. Mund të shpaloset në një raport të veçantë dhe t'u shpërndahet të gjithë menaxhmentit të lartë.
  - D. Mund të shpaloset në një raport të veçantë dhe t'i shpërndahet komitetit të bordit të drejtorëve të kompanisë.**
14. Si shefi ekzekutiv i auditimit i ndërmarrjes ku jeni të punësuar, ju keni zhvilluar një plan që përfshin një plan të detajuar të fushave që do të auditohen gjatë vitit të ardhshëm, një vlerësim të kohës së nevojshme për secilin auditim, dhe datën e përafërt të fillimit të secilit auditim. Caktimi i auditimeve specifike bazohet në kohën e kaluar që nga kontrolli i fundit në secilën zonë. Plani është i papërshtatshëm sepse nuk arrin të:
- A. Citoj mbështetjen autoritare, siç janë Standardet IIA, për një plan të tillë.
  - B. Marr parasysh faktorë të tillë si rrezikun, ekspozimin dhe humbjen e mundshme të ndërmarrjes.**
  - C. Tregoj nëse të gjitha burimet e auditimit janë angazhuar në plan.
  - D. Kërkoj miratimin e planit nga menaxhmenti.
15. Standardet e IIA tregojnë se pavarësia lejon auditorët e brendshëm të japin gjykime të paanshme të cilat janë thelbësore për kryerjen e duhur të auditimeve. Cila nga opsionet e mëposhtme do të promovonte më së mirë pavarësinë?
- A. Një politikë që kërkon që auditorët e brendshëm të raportojnë tek shefi ekzekutiv i auditimit çdo situatë në të cilën ekziston një konflikt interesi ose paragjykim nga ana e auditorit individual ose mund të interpretohet si e tillë.**
  - B. Një politikë e departamentit të auditimit të brendshëm që nuk lejon që ajo të rekomandojë standarde të kontrolleve për sistemet që ai auditon.
  - C. Një politikë organizative që lejon që kontrollet e brendshme të operacioneve të ndjeshme të kontraktohen nga ofruesit e jashtëm të shërbimeve të auditimit.
  - D. Një politikë organizative që parandalon transferimet e personelit nga aktivitetet operative në departamentin e auditimit të brendshëm.
16. Kodi i Etikës i IIA kërkon që auditorët e brendshëm të ushtrojnë tre cilësi të veçanta në kryerjen e detyrave të tyre. Këto tre cilësi janë:
- A. Ndershmëria, zelli dhe përgjegjësia.**
  - B. Njohuri, maturia dhe qartësia.
  - C. Njohuri, aftësi dhe disiplinë.
  - D. Përpikëri, besnikëri dhe dinjitet.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

17. Cila nga opsionet e mëposhtme përfshin shkelje të Kodit të Etikës të IIA?
- A. Një auditor informoi një mik në një departament operativ për mbylljen e pritshme të këtij departamenti.**
  - B. Ndryshe nga punonjësit e tjerë, auditorët gjithmonë udhëtojnë me bileta të klasit të parë për të ruajtur pavarësisë në dukje.
  - C. Me pëlqimin e menaxhmentit të lartë, një auditor pranoi një dhuratë nga një departament i audituar që u dha si shpërblim për gjetjen e një jo efikasiteti të madh.
  - D. Një auditor pranoi një kalendar promovues nga menaxheri i shitjeve.
18. Një shef ekzekutiv i auditimit mëson se një auditor i stafit i ka dhënë një informacion konfidencial një të afërmi. Si shef ekzekutiv i auditimit ashtu edhe auditori i stafit janë Auditorë të Brendshëm të Çertifikuar. Megjithëse auditori nuk përfitoi nga transaksioni, i afërmi përdori informacionin për të realizuar një fitim të madh. Mënyra më e përshtatshme për shefin ekzekutiv të auditimit për t'u marrë me këtë problem është:
- A. Të qortoj verbalisht auditorin.
  - B. Të shkarkoj auditorin dhe të njoftoj shoqatën e cila e ka çertifikuar auditorin.
  - C. Mos ndërmarr asnjë veprim pasi auditori nuk përfitoi nga transaksioni.
  - D. Të informoj bordin e drejtorëve të shoqatës e cila e ka çertifikuar auditorin dhe të ndërmarr veprimet e personelit të kërkuara nga politika e kompanisë.**
19. Një nga qëllimet kryesore për krijimin e një kodi të mirësjelljes brenda një organizate profesionale është:
- A. Të zvogëlohen mundësit që anëtarët e profesionit të paditen për punët e kryera nën nivelin e përcaktuar me standarde.
  - B. Të sigurohet që të gjithë anëtarët e profesionit ofrojnë shërbimet afërsisht në të njëjtin nivel të kompetencës.
  - C. Të demonstroj pranimin e përgjegjësisë ndaj interesave të atyre që shërbehen nga profesioni.**
  - D. Të kërkoj nga anëtarët e profesionit të shfaqin besnikëri në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me punët e organizatës së tyre.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

20. Një institucion i madh financiar disa vjet më parë krijoi një kod të mirësjelljes dhe u shpërndau kodin e mirësjelljes të gjithë zyrtarëve dhe punonjësve të tij. Identifikoni qasjen më të mirë të auditimit për t'i ofruar komitetit të auditimit nivelin më të lartë të sigurisë për implementimin e kodit të sjelljes:
- A. Vlerësoni plotësisht gjithë-përfshirjen e kodit dhe pajtueshmërinë me të, dhe raportoni rezultatet te komiteti i auditimit.**
  - B. Vlerësoni plotësisht praktikën e ndërmarrjes për pajtueshmërinë me kodin dhe raportoni tek komiteti i auditimit.
  - C. Rishikoni aktivitetet e punonjësve për pajtueshmëri me dispozitat e kodit dhe raportoni tek komiteti i auditimit.
  - D. Kryeni teste në transaksione të ndryshme të punonjësve për të zbuluar shkelje të mundshme të kodit të mirësjelljes.
21. Cila nga sistemet e mëposhtme të kontrollit të menaxhimit mat performancën në aspektin e fitimit operativ minus kosto e kapitalit të investuar në pasuritë e prekshme?
- A. Sistemi i menaxhimit të librit të hapur (open-book).
  - B. Sistemi ekonomik me vlerë të shtuar.**
  - C. Sistemi i kostos së bazuar në aktivitete.
  - D. Sistemi i vlerës së shtuar të tregut.
22. Kontrolli është përshkruar si një sistem i mbyllur i përbërë nga gjashtë elemente. Identifikoni njërin nga gjashtë elementet.
- A. Vendosja e standardeve të performancës.**
  - B. Sigurimi adekuat i dosjeve të të dhënave
  - C. Miratimi i kartës së auditimit.
  - D. Themelimi i funksionit të auditimit të pavarur.
23. Cila nga kontrollet e të dhënave hyrëse (input controls) ose kontrolleve të modifikimit do të zbulonte lloje të caktuara të gabimeve brenda fushës së shumës së pagesës së një transaksioni?
- A. Numërimi i regjistrimeve.
  - B. Kontrolli echo.
  - C. Kontrollimi i shifrës.
  - D. Kontrollimi i limitit.**
24. Për t'u siguruar që mallrat e pranuar janë të njëjta me ato të paraqitura në faturën e blerjes, një sistem i kompjuterizuar duhet të:
- A. Harmonizojë fushat e zgjedhura të faturës së blerjes me mallrat e pranuar.**
  - B. Mbjaj në kontroll vlerën totale të stoqeve.
  - C. Llogarit totalin e grumbulluar për çdo hyrje.
  - D. Përdorë kontrollin e shifrave në numrat e llogarisë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

25. Një auditor i ri është duke u informuar për llojet e ndryshme të auditimeve nga mbikëqyrësi i auditimit. Mbikëqyrësi thekson se disa fusha brenda organizatës janë më të vështira për t'u audituar, sepse kontrollet në përgjithësi nuk janë të përcaktuara aq qartë si në departamentet e tjera. Zgjidhni llojin e kontrollit që zakonisht është më i vështirë për t'u vlerësuar.

- A. Operativ.**
- B. Harduerik.
- C. Kontabiliteti.
- D. Siguria fizike.

26. Sipas raportit të COSO, plani i auditimit ndryshon kur:

- I. Rreziqet ndryshojnë.
- II. Burimet e auditimit ndryshojnë.
- III. Ndryshon Bordi.
- IV. Politikat ndryshojnë.

- A. Vetëm I.
- B. I dhe II.**
- C. III dhe IV.
- D. I, II, III, IV.

27. Qëllimi i kontrollit është:

- A. Të kontrollojë sjelljen e punëtorëve.
- B. Të përcaktojë se kush është përgjegjës për një departament.
- C. Të sigurojë se objektivat e kompanisë po arrihen.**
- D. Të përcaktojë nëse një operacion është një qendër kostoje apo fitimi.

28. Drejtorët e korporatave, menaxhmenti, auditorët e jashtëm dhe auditorët e brendshëm, - të gjithë luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli. Menaxhmenti i lartë është kryesisht përgjegjës për:

- A. Krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe specifikimin e një strukture të përgjithshme të kontrollit të brendshëm.**
- B. Rishikimin e besueshmërisë dhe integritetit të informacionit financiar dhe mjeteve të përdorura për mbledhjen dhe raportimin e informacionit të tillë.
- C. Sigurimin se auditorët e jashtëm dhe të brendshëm monitorojnë në mënyrë adekuate mjedisin e kontrollit.
- D. Zbatimin dhe monitorimin e kontrolleve të hartuara nga bordi i drejtorëve.



Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

29. Qëllimi kryesor i operimit të një linje të posaçme të pandërprerë (hotline) për mashtrimet brenda kompanisë është:
- A. Zvogëlon kostot totale të operimit të kompanisë.
  - B. Mat se sa mirë njësitë organizative janë duke arritur qëllimet e organizatës.
  - C. Krijon kanale të komunikimit për njerëzit për të raportuar keqpërdorimet e dyshuara.**
  - D. Përqendrohet në fushat që meritojnë vëmendje dhe vendos më pak vëmendje në zonat që funksionojnë siç është pritur.
30. Një agjent i blerjeve, bleu artikuj për përdorim personal me fondet e kompanisë. Kompania ju lejon punonjësve të caktuar të blejnë më shumë se 250€ mallra në ditë sipas kontratave të hapura. Aprovimi i blerjeve nga ana e mbikëqyrësit ishte e nevojshme, por ky informacion nuk i ishte komunikuar palës shitëse (furnitorëve). Në vend të shqyrtimit dhe autorizimit të secilës urdhër-blere, mbikëqyrësi në mënyrë rutinore nënshkruan fletën e autorizimit në fund të muajit pa rishikuar ndonjë dokumentacion mbështetës. Meqenëse blerjet e kësaj natyre nuk ishin objekt i politikave normale të kompanisë për pranimet, punonjësi i pandershëm mori furnizimet në depon e shitësit. Të gjitha blerjet ishin për artikujt e porositur në mënyrë rutinore nga kompania. Gjatë vitit të kaluar, punonjësi grumbulloi mallra të mjaftueshme për të filluar një biznes printimi dhe fotografie. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të ishte më efektive në zbulimin e këtij mashtrimi?
- A. Gjurmimi i çeqeve të anuluar, të përzgjedhura, me ditarin e pagesave në para të gatshme dhe me faturat e palëve shitës (furnitorëve).
  - B. Kryerja e analizës së trendit të furnizimeve për shpenzime printime për një periudhë dyvjeçare.**
  - C. Gjurmimi i çmimeve dhe sasive në faturat e palëve shitëse (furnitorëve) të përzgjedhur me urdhër-blertet përkatëse.
  - D. Rillogaritja e saktësisë së faturave të palëve shitëse (furnitorëve) të përzgjedhur, duke përfshirë zbritjet dhe taksat e shitjes.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

31. Gjatë hetimit të një rritje prej 200,000€ në furnizimet e mirëmbajtjes gjatë vitit të kaluar, një agjent i blerjes i shpjegoi auditorit se arsyeja kryesore për rritjen ishin shërbimet dhe materialet e pikturimit. Auditori gjeti një urdhër blerjeje të një pëlhure pa ofertën normale ose dokumentacionin kuotues. Urdhër blerja për pëlhurën ishte nënshkruar nga menaxheri i përgjithshëm dhe babai i menaxherit të përgjithshëm ishte shënuar si kontraktori i vetëm për shërbimet e pikturimit në projektet e kompanisë. Auditori gjithashtu gjeti një numër të madh të faturave të autorizuara për pagesë nga menaxheri i përgjithshëm dhe në të cilat babai i menaxherit të përgjithshëm ishte personi që nënshkroi faturën nga ana e furnizuesit. Indikatorit i përbashkët i mashtrimeve të njohura nga auditori në këtë skenar është që:

**A. Procedurat analitike zbuluan një rritje të jashtëzakonshme në saldot e llogarive.**

B. Ngjyrat dhe materialet janë duke u blerë për një kontraktues.

C. Agjenti i blerjes është duke për zgjedhur kontraktorin në baza të një urdhër blerjeje të përgjithshme.

D. Faturat janë duke u autorizuar për pagesë nga menaxheri i përgjithshëm.

32. Menaxhmenti i Bankës dyshon se një zyrtar për kredi i bankës shpesh ka dhënë hua për kompanitë fiktive, ka arkëtuar shumat e kredisë në llogarinë personale dhe duke lënë kështu kreditë si të papaguara në kohë. Disa fakte përkatëse në lidhje me zyrtarin për kredi përfshijnë:

— Një standard i lartë jetese, i shpjeguar si rezultat i investimeve të shëndosha dhe mos marrjes së pushimeve.

— Një makinë e shtrenjtë personale e fituar nëpërmjet kontakteve të biznesit.

— Faturat e benzinës dhe të riparimit të dorëzuara nga kompania e makinave e përcaktuar nga banka, që janë më të larta se mesatarja e kompanisë (shkrimet e kilometrave janë dorëzuar në baza tremujore).

— Bezdi e dukshme lidhur me pyetjet nga auditorët.

Analiza e trendit, më e përshtatshme për të treguar këtë mashtrim të mundshëm është:

**A. Normat e kredive të papaguara të lëshuara nga ky zyrtar i kredive.**

B. Akumulimi i ditëve të papaguara të pushimeve.

C. Shpenzimet operative të automjetit të bëra nga ky zyrtar i kredive.

D. Vëllimi total i dollarit të kredive të lëshuara nga ky zyrtar i kredive.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

33. Departamenti i auditimit të brendshëm është caktuar për të kryer një auditim të një divizioni. Bazuar në rishikimin e dokumentacionit, auditori ka njohuri në lidhje me politikat e menaxhimit si në vijim:

- Politika e kompanisë është që të promovojë menjëherë menaxherët e divizioneve që tregojnë sukses domethënës. Si rrjedhojë, menaxherët e suksesshëm rrallë qëndrojnë në një divizion për më shumë se tre vjet.
- Një pjesë e konsiderueshme e kompensimit të menaxherëve të divizioneve vjen në formën e shpërblimeve bazuar në profitabilitetin e divizionit.

Divizioni u identifikua nga menaxhmenti i lartë si një mundësi për kthimin e investimeve. Divizioni është duke u rritur, por nuk është planifikuar për këtë vit një auditim i plotë nga auditorët e jashtëm. Divizioni është rritur me rreth 7% në vit për tre vitet e fundit dhe përdor një sistem të kostos standarde.

Gjatë auditimit të ndërmjetëm, auditori vë në dukje ndryshimet në vijim në të dhënat financiare në krahasim me vitin paraprak:

- Shitjet janë rritur me 10%.
- Kostoja e mallrave të shitura është rritur me 2%.
- Stoqet janë rritur me 15%.
- Të ardhurat neto të divizionit janë rritur me 8%.

Nëse auditori vendos se ka probleme të rëndësishme me sistemin e kostos standarde, hapi i ardhshëm i kryerjes së auditimit do të ishte:

- A. Intervistoni menaxhmentin e divizionit për të përcaktuar pse sistemi i kostos standarde nuk është azhurnuar në kohën e duhur.
- B. Zgjidh një mostër të rastësishme të produkteve dhe rishikoni ndërtimin e kostos standarde duke gjetur blerjet në regjistrin e kostos standarde.
- C. Përdorni softuer të përgjithësuar të auditimit për të përgatitur një listë të marzhës bruto sipas produktit duke krahasuar koston standarde me çmimin e shitjes. Zgjidh të gjitha artikujt me marzhë bruto të lartë për hetime të mëtejshme.
- D. Programoni të gjitha variancat dhe përcaktoni burimin dhe prirjen e tyre (dmth., a i janë alokuar stoqeve apo kostos së mallrave të shitura).**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

34. Artan Gashi ishte menaxher rajonale i shitjeve për një kompani për më shumë se dhjetë vite. Gjatë kësaj kohe ai ishte bërë mik shumë i afërt me Besart Krasniqin, një menaxher i auditimit të brendshëm. Përveç që ishin fqinjë, Artani dhe Besarti kishin interesa shumë të njëjtat dhe i përkisnin të njëjtit klub tenisi. Ata i besonin njëri-tjetrit. Besarti i kishte ndihmuar Artanit të zgjidhte disa probleme shitjesh dhe Artani i kishte dhënë Besartit disa informata që çuan në zbulime të rëndësishme të auditimit gjatë tri auditimeve të kaluara.

Më poshtë janë për zgjedhur të dhënat analitike nga kompania që kanë shtyrë stafin e auditimit të besojë se ka pasur një mashtrim të pasqyrave financiare. Kryerësi duket se ka falsifikuar informacionin e shitjes për dy vitet e fundit. Besarti është i shqetësuar për shkak se ai kohët e fundit ka përfunduar një auditim në këtë fushë dhe ka pranuar shpjegimin e Artanit për dallimet në të dhënat analitike. Besarti tani është i bindur se Artani është përfshirë në mashtrime.

Cili kombinim i të dhënave analitike të mëposhtme ofron treguesin më të mirë të mundësisë së mashtrimit?

Periudha	Rritja e % në shitje	Qarkullimi i stoqeve	% e marzhës bruto	Ndryshimi në % në kthimin e shitjeve
Viti aktual	10%	5	54	8%
Viti paraprak	8%	4	49	6%
- 2 vite	6%	5	42	3%
- 3 vite	4%	3.5	39	2.5%
- 4 vite	5%	4	40	3%

- A. Rritja e përqindjes në shitjet dhe qarkullimi i stoqeve.
- B. Përqindja e marzhës bruto dhe ndryshimi në kthimin e shitjeve.**
- C. Qarkullimi i stoqeve dhe ndryshimi në kthimin e shitjeve.
- D. Rritja në përqindje e shitjeve dhe përqindjes së marzhës bruto.

35. Si pjesë e testit të efektivitetit të një plani për rigjenerimin e katastrofave natyrore, auditori planifikon të intervistojë pesë punonjës nga pesë departamente të ndryshme (25 punonjës gjithsej). Pas intervistave të para, cila do të ishte mënyra më e mirë që auditori të mbetet i vëmendshëm gjatë intervistave të mbetura?

- A. Bëni pyetje krejtësisht të ndryshme për të qëndruar i interesuar.
- B. Bëni pyetjet në një format paksa të ndryshëm dhe në një sekuençë tjetër.**
- C. Kërkoni që pjesa tjetër e punonjësve të shkruajnë përgjigjet e tyre.
- D. Intervistoni punonjësit e mbetur në grupe prej katër ose pesë vetash.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

36. Një auditor po harton një plan të marrjes së mostrave për të vërtetuar saktësinë e raporteve ditore të prodhimit gjatë tre viteve të fundit. Të gjitha raportet përmbajnë të njëjtin informacion përveç raporteve të ditës së premte që përmbajnë edhe gjithsej raportin javor dhe përgatiten nga menaxherët sesa nga mbikëqyrësit. Prodhimi normalisht arrin kulmin në fund të një muaji. Nëse auditori dëshiron të zgjedhë dy raporte në muaj duke përdorur një plan të marrjes së mostrës në interval, cila nga teknikat e mëposhtme zvogëlon gjasat e paragjykitimit në mostër?
- A. Vlerësimi i shkallës së gabimit në popullatë.
  - B. Përdorimi i disa zgjedhjeve me një fillim të rastësishëm**
  - C. Rritja e nivelit të besimit.
  - D. Rritja e saktësisë.
37. Cila nga pohimeve të mëposhtme në lidhje me marrjen e mostrave është e vërtetë?
- A. Një mostër më e madhe është gjithmonë më përfaqësuese e popullatës themelore sesa një mostër më e vogël.
  - B. Për popullatat shumë të mëdha, madhësia absolute e një mostre ka më shumë ndikim në saktësinë e rezultateve të saj sesa ka madhësia e saj në raport me popullsinë e saj.**
  - C. Për një madhësi të dhënë të mostrës, një mostër e thjeshtë e rastësishme gjithmonë prodhon mostrën më përfaqësuese.
  - D. Kufizimet e një kornize jo të plotë të mostrës pothuajse gjithmonë mund të tejkalohen nga teknikat e kujdesshme të marrjes së mostrave.
38. Një kompani me 14,344 klientë përcakton që moda dhe mediana e llogarive të arkëtueshme për vitin janë përkatësisht 15,412€ dhe 10,382€. Nga ky informacion, auditori mund të konkludojë se shpërndarja e gjendjeve të llogarive të arkëtueshme është e vazhdueshme dhe:
- A. Anuar negativisht.
  - B. E anuar pozitivisht.**
  - C. E prirur në mënyrë simetrike.
  - D. Shpërndarë në mënyrë të barabartë midis modës dhe medianës.
39. Masa e ndryshueshmërisë së mostrës statistikore e cila shërben si një metodë vlerësimi e ndryshueshmërisë së popullatës njihet si:
- A. Saktësi themelore.
  - B. Rang
  - C. Devijim standard.**
  - D. Interval.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

40. Në përzgjedhjen e mostrave të auditimit, ekzistojnë rreziqe të gabimeve të Tipit I dhe Tipit II. Këto rreziqe:

- A. Rezultojnë direkt nga mundësia që mostra e marrë nga auditori i brendshëm të mos jetë përfaqësuese e popullatës.**
- B. Mund të ulen duke përdorur procedura më të besueshme, megjithëse më të shtrenjta, të auditimit.
- C. Kanë një ndikim që bazohet vetëm në pasojat ekonomike të konkluzioneve të pasakta të bazuara në mostra.
- D. Referohen përkatësisht rreziqeve që (1) kontrollet e brendshme do të dështojnë dhe (2) gabimi rezultues do të mbetet i pazbuluar.

41. Madhësia e një mostre të dhënë të auditimit është rezultat i karakteristikave të popullatës si dhe vendimeve të marra nga auditori i brendshëm. Nëse çdo gjë tjetër është e njëjtë, madhësia e mostrës do të:

- A. Rritet nëse auditori i brendshëm vendos të pranojë më shumë rrezik për të konkluduar gabimisht se kontrollet janë efektive kur ato janë në të vërtetë joefektive.
- B. Dyfishohet nëse auditori i brendshëm konstaton se ndryshimi i popullsisë është dy herë më i madh sesa tregohet në mostrë.
- C. Zbritet nëse auditori i brendshëm rrit sasinë e gabimit të tolerueshëm.**
- D. Rritet ndërsa rritet rreziku i gabimit të marrjes së mostrave.

42. Një auditor i brendshëm dëshiron të vlerësojë numrin e njërive në një klasë të caktuar të inventarit pa llogaritur secilën. Cili nga planet e mëposhtme të mostrimit do të ishte i përshtatshëm?

- A. Mostrimi sipas veçorive
- B. Mostrimi i zbulimit.
- C. Plani i mostrimit 'ndal-dhe-shkon'.
- D. Mostrimi sipas variablave.**

43. Mostrimi përmes vlerësimit të koeficienteve do të ishte i papërshtatshëm për t'u përdorur për të projektuar gabimin monetar në një popullatë nëse:

- A. Vlerat e regjistruara në libra dhe vlerat e audituara janë përafërsisht proporcionale.
- B. Ekzistojnë një numër ndryshimesh të vërejtura midis vlerave të librave dhe vlerave të audituara.
- C. Dallimet e vërejtura midis vlerave të librave dhe vlerave të audituara janë proporcionale me vlerat e librave.
- D. Bilancet për disa zëra të inventarit në librin kryesorë janë të panjohura.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Mrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

44. Modulet e inkorporuara të auditimit:

- A. Identifikojnë kodin kompjuterit të pazbatuar.
- B. Ndihmojnë gjatë procesit të gjetjes së gabimeve në sistemet e aplikimit.
- C. Analizojnë efikasitetin e programimit.
- D. Mundësojnë monitorimin e vazhdueshëm të përpunimit të transaksioneve.**

45. Cili nga elementet e mëposhtme, është burimi më efikas që mund të përdorë një auditor për të vlerësuar sistemin e përgjithshëm të kontrollit të kompanisë?

- A. Skemat e rrjedhjes së punës kontrollit.**
- B. Kopjet e procedurave standarde të operacioneve.
- C. Një tregim që përshkruan historinë e departamentit, aktivitetet, dhe formularët e përdorur.
- D. Kopjet e standardeve operacionale të industrisë.

46. Gjatë dokumentimit të procedurave të përdorura nga disa departamente që bashkëveprojnë me njëri tjetrin, auditori i brendshëm me mundësi të madhe do të përdorë:

- A. Një skemë horizontale të rrjedhjes së punës.**
- B. Një skemë vertikale të rrjedhjes së punës.
- C. Një grafik Gantt.
- D. Një pyetësor mbi kontrollet e brendshme.

47. Gjatë një auditimi, auditori i brendshëm duhet të marrë në konsideratë faktorin (faktorët) e mëposhtëm në përcaktimin e shkallës deri tek e cila duhet të përdoren procedurat analitike:

- A. Përshtatshmëria e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- B. Rëndësia e fushës që po kontrollohet.
- C. Saktësia me të cilën mund të parashikohen rezultatet e procedurave analitike të auditimit.
- A. Të gjitha të mësipërmet.**

48. Cili nga format e mëposhtme të dëshmisë paraqet dëshminë më kompetente që një llogari e arkëtueshme ekziston faktikisht?

- A. Një konfirmim pozitiv.**
- A. Një faturë e shitjes.
- B. Një raport pranimi.
- C. Një faturë e ngarkesës.

49. Cila nga evidencat e mëposhtme NUK mund të përdoret për të kundërshtuar një evidencë me shkrim?

- B. Evidencat gojore.**
- C. Evidenca e dokumentuar.
- D. Evidenca rrethanore.
- E. Evidenca vërtetuese.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

50. Cila nga evidencat e mëposhtme NUK ka nevojë për vërtetim?

B. Evidenca prej opinioneve.

**C. Evidenca konkluduese.**

D. Evidencat thashetheme.

E. Evidenca rrethanore.